



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.48

24 prill

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9701 datë 2.4.2007	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar	1231
Ligj nr.9705 datë 2.4.2007	Për faljen e kamatëvonesave të papaguara të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore	1236
Ligj nr.9706 datë 5.4.2007	Për një shtesë në ligjin nr.8685, datë 9.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar.....	1237
Ligj nr.9707 datë 5.4.2007	Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë.....	1237
Ligj nr.9708 datë 5.4.2007	Për disa shtesa në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	1253
Ligj nr.9710 datë 10.4.2007	Për portet turistike në Republikën e Shqipërisë	1254
Rezolutë e Kuvendit datë 5.4.2007	Për vlerësimin e veprimtarisë së RTSH-së për vitin 2006.....	1258
Rezolutë e Kuvendit datë 10.4.2007	Për vlerësimin e punës së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive për vitin 2006	1259

LIGJ
Nr.9701, datë 2.4.2007

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7843, DATË 13.7.1994 “PËR
REGJISTRIMIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Në fund të nenit 1 shtohet përkufizimi me këtë përmbajtje:

“Regjistrim fillestar” është regjistrimi për herë të parë i pasurisë së paluajtshme, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj dhe në nenin 192 të Kodit Civil.

Neni 2

Neni 2/1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 2/1

Objekti i veprimtarisë

Objekt i veprimtarisë së zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme është regjistrimi i titujve të pronësisë dhe të të drejtave të tjera reale për pasuritë e paluajtshme në bazë të dokumenteve ligjore, që vërtetojnë pronësinë mbi pasurinë e paluajtshme, si dhe përgatitja, mbajtja dhe administrimi i regjistrave të pasurive të paluajtshme, hartave treguese të regjistrimit dhe dokumentacionit, që vërtetojnë të drejtën e pronësisë dhe të drejtat e tjera reale mbi pasurinë e paluajtshme.”.

Neni 3

Në nenin 3, paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme drejtohet nga Kryeregjistruesi dhe, në mungesë të tij, nga njëri prej dy zëvendëskryeregjistruesve.

Kryeregjistruesi emërohet dhe shkarkohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë.

Zëvendëskryeregjistruesit emërohen dhe shkarkohen nga Ministri i Drejtësisë, me propozimin e Kryeregjistruesit.”.

Neni 4

Në nenin 4 shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) informacioni filmik dhe elektronik.”.

Neni 5

Në nenin 10, pas paragrafit të parë shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Në rastet kur, për të njëjtën pasuri, janë bërë më shumë se disa regjistrime, të cilat nuk kanë

rrjedhur nga njëri-tjetri, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, regjistruesi, me vendim të arsyetuar, i kërkon Kryeregjistruesit të vendosë fshirjen e regjistrimeve të kryera pas regjistrimit të parë, kur ky i fundit është në përputhje me nenet 192-197 të Kodit Civil, duke bërë shënimin në kolonën përkatëse. Deri në nxjerrjen e vendimit të Kryeregjistruesit për miratimin ose refuzimin e kësaj kërke, regjistruesi bën pezullimin e regjistrimit dhe mbi pasurinë nuk mund të kryhen veprime, si dhe njofton palën/palët e interesuara brenda 10 ditëve. Konfirmimi i marrjes së njoftimit depozitohet në dosjen përkatëse.

Kryeregjistruesi merr vendim brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës. Në rast të mosmarrjes së vendimit nga Kryeregjistruesi, zbatohet neni 328 i Kodit të Procedurës Civile. Vendimi i Kryeregjistruesit i njoftohet palës/palëve të interesuara brenda 10 ditëve dhe konfirmimi i marrjes së njoftimit depozitohet në dosjen përkatëse.”.

Neni 6

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 12 Vonesa në regjistrim

Nëse një dokument paraqitet për regjistrim më vonë se 30 ditë nga data e realizimit të tij, përveç tarifës së regjistrimit, për çdo ditë vonesa, që ka kaluar nga kjo datë, paguhet kamatëvonesë e barabartë me 10 për qind të tarifës së regjistrimit.”.

Neni 7

Nenet 13, 19 e 20 shfuqizohen.

Neni 8

Në nenin 21 bëhen ndryshimi e shtesa si më poshtë:

a) Në paragrafin e fundit hiqen fjalët “dhe të vërtetuar nga organi përkatës se është në përputhje me ligjet në fuqi.”

b) Në fund të nenit shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

“Kur pasuritë e paluajtshme, ngjitur njëra-tjetrës, janë pronë e pronarëve të ndryshëm, regjistruesi mund të bëjë bashkimin e tyre në të gjitha rastet kur pronarët paraqesin deklaratën noteriale, ku shprehet pëlqimi i palëve për bashkim të pasurive, e shoqëruar me plan rievimi, të përgatitur nga topografi i licencuar.

Në të gjitha rastet, pronarët dorëzojnë në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme certifikatën origjinale të pasurisë, që do të bashkohet ose ndahet, si dhe pajisen me certifikata të reja pronësie për pasuritë e krijuara.”.

Neni 9

Në nenin 23, pas fjalëve “ së një karteles” shtohen fjalët “dhe të një harte treguese të regjistrimit”.

Neni 10

Në nenin 24, shkronjat “a”, “b” dhe “c” ndryshohen si më poshtë:

“a) Pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme përcaktohen nga aktet e fitimit të pronësisë, sipas nenit 193 të Kodit Civil.

b) Individët, familjet dhe personat juridikë, privatë apo shtetërorë, që zotërojnë dokumente pronësie, sipas shkronjës “a”, por nuk kanë të përcaktuar në to sipërfaqen e pasurisë së paluajtshme, kanë të drejtë t’i paraqesin regjistruesit një kërkesë për regjistrim pronësie, e cila duhet të shoqërohet me dokumentin e pronësisë, me një planvendosje apo genplanin e pasurisë, deklaratën noteriale të pronarëve fqinjë, që vërtetojnë përmbajtjen e kërkesës për pronësinë dhe kufijtë e pasurisë që pretendohet, si dhe kopje të vërtetuara nga noteri të dokumenteve të ndryshme, që mbështesin

kërkesën për regjistrim.

Regjistruesi, brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës, duhet t'i kthejë përgjigje kërkuarit pas pagesës së shpenzimeve, të cilat parapaguhën nga kërkuari.

Kundër vendimit të regjistruesit ose në mungesë të përgjigjes, me kalimin e këtij afati, kërkuari mund të ankohet në gjykatë. Në procesin gjyqësor gjykata thërret të gjithë pronarët, pronat e të cilëve janë ngjitur njëra-tjetrës e të cilët kanë interes të ligjshëm në gjykim.

c) Për kalimin në pronësi të sipërfaqes, kur në dokumentin e pronësisë është bërë shënimi “oborr në përdorim”, kërkuarit duhet t'u drejtohen organeve të kthimit dhe kompensimit të pronave. Për rastet, të cilat nuk janë subjekt i ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave, kërkuarit i drejtohen institucionit të autorizuar nga Këshilli i Ministrave. Procedura e kalimit të kësaj sipërfaqeje në pronësi, në këto raste, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 11

Në të tre paragrafët e nenit 25, shifra “90” ndryshohet në “45”.

Neni 12

Në nenin 27 shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Regjistrimi i një pasurie nuk mund të krijojë mbivendosje me prona të regjistruara më parë, përveç rasteve kur kemi humbje ose ndryshim të pronësisë së regjistruar, sipas neneve 37 e 38 të këtij ligji.

Në rastet kur dokumentet e paraqitura për regjistrim janë të vlefshme, por krijojnë mbivendosje me një pasuri të regjistruar më parë, regjistruesi, me vendim të arsyetuar, refuzon regjistrimin e pasurisë për atë pjesë që krijon mbivendosjen, deri në zgjidhjen gjyqësore dhe orienton kërkuarin për zgjidhjen e çështjes në rrugë administrative e gjyqësore.”.

Neni 13

Neni 32 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 32

Regjistrimi i kontratës së qirasë

Kontrata e qirasë për një pasuri të paluajtshme, për një periudhë kohore deri në nëntë vjet, nuk është e detyrueshme të regjistrohet. Çdo kontratë qiraje për një pasuri të paluajtshme, me zgjatje kohore më shumë se 9 vjet, duhet të regjistrohet në seksionin përkatës të kartelës së pasurisë së paluajtshme të qiradhënësit.

Kur një kontratë qiraje është për pjesë të pasurisë së paluajtshme, atëherë kartela ekzistuese e pasurisë së paluajtshme mbyllet dhe hapen kartela të reja për pjesën/pjesët, që është/janë dhënë me qira dhe për pjesën/pjesët e pasurisë së paluajtshme që mbetet/mbeten, si dhe bëhen shënimet përkatëse në hartën treguese të pasurive të paluajtshme. Në këto raste, në zyrën përkatëse të regjistrimit të pasurive të paluajtshme depozitohet certifikata e pronësisë së pasurisë që do të ndahet.

Zyra e regjistrimit regjistron edhe të drejtën e parablerjes, në zbatim të nenit 14 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar.”.

Neni 14

Neni 37 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 37

Regjistrimi i fitimit të pronësisë me parashkrim fitues

Regjistrimi i fitimit të pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme, me parashkrim fitues, bëhet pas paraqitjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë të regjistruesi për këtë fitim pronësie.

Në përputhje me këtë vendim, regjistruesi regjistron si pronar të pasurisë së paluajtshme personin që e ka fituar atë me parashkrim fitues.

Regjistrimi i fitimit të pronësisë, sipas këtij neni, bëhet nga zyra e regjistrimit të pasurive të

paluajtshme pas plotësimit të kushteve të regjistrimit, të përcaktuara në shkronjën “h” dhe në paragrafin e fundit të nenit 193 të Kodit Civil. Në rast se nuk plotësohen kushtet e sipërpërmendura, regjistruesi propozon refuzimin e kërkesës për regjistrim dhe dosja e plotë e praktikës, së bashku me urdhrin e refuzimit, i kalojnë për kompetencë Kryeregjistruesit.

Kryeregjistruesi, brenda 30 ditëve, me urdhër të arsyetuar, duhet të vendosë miratimin ose jo të propozimit. Kundër urdhrit të Kryeregjistruesit për refuzimin e regjistrimit mund të bëhet ankim në rrugë gjyqësore.

Elementet e vendimit, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe procedura e nxjerrjes së urdhrit përcaktohen me udhëzim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 15

Neni 38 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 38

Regjistrimi i fitimit të pronësisë me anë të ligjit, vendimit gjyqësor apo aktit administrativ

Në rastet kur shteti, personi, fizik ose juridik, ka fituar të drejtën e pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme me anë të ligjit, vendimit gjyqësor të formës së prerë për fitimin ose kalimin e së drejtës së pronësisë apo të aktit të një organi administrativ, regjistruesi, mbështetur në këto akte të paraqitura nga personi i interesuar, bën regjistrimin, duke shënuar pronar shtetin, personin, fizik ose juridik, të cilit i ka kaluar e drejta e pronësisë.

Regjistrimi i fitimit të pronësisë, sipas këtij neni, bëhet nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme pas plotësimit të kushteve të regjistrimit, të përcaktuara në shkronjën “h” dhe në paragrafin e fundit të nenit 193 të Kodit Civil.

Nëse nuk plotësohen kushtet e sipërpërmendura, regjistruesi propozon refuzimin e kërkesës për regjistrim dhe dosja e plotë e praktikës, së bashku me urdhrin e refuzimit, i kalojnë për kompetencë Kryeregjistruesit.

Kryeregjistruesi, brenda 30 ditëve, me urdhër të arsyetuar, duhet të vendosë miratimin ose jo të propozimit. Kundër urdhrit të Kryeregjistruesit për refuzimin e regjistrimit mund të bëhet ankim në rrugë gjyqësore.

Elementet e vendimit, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe procedura e nxjerrjes së urdhrit përcaktohen me udhëzim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 16

Pas nenit 39 shtohet neni 39/a me këtë përmbajtje:

“Neni 39/a

Regjistruesi nuk mund të pranojë asnjë regjistrim të ri të një prone, nëse për këtë pronë ka një regjistrim të mëparshëm të një titulli, sipas neneve 37 e 38 të këtij ligji.

Nëse regjistruesi është vënë në dijeni se një regjistrim i mëparshëm është kryer në kundërshtim me këtë nen, atëherë ai procedon sipas nenit 10 të këtij ligji.”.

Neni 17

Pas nenit 41 shtohet neni 41/a me këtë përmbajtje:

“Neni 41/a

Regjistrimi i ndërtimeve të reja

Regjistruesi, me kërkesë të investitorit dhe të pronarit, bën regjistrimin e përkohshëm të objektit në fazën e përfundimit të karabinasë, si dhe lëshon certifikatën përkatëse, në përputhje me

nenin 12/1 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. Ky regjistrim bëhet me kolonë të ndryshme nga ajo e trullit, në të cilin po kryhet ndërtimi dhe është i vlefshëm deri në përfundimin e objektit, për efekt të kreditimit të investitorit ose regjistrimit të kontratave paraprake.

Me kërkesën e palës së interesuar, regjistruesi bën regjistrimin e kontratave paraprake të shitjes së pjesëve të një ndërtimi të ri dhe i pajis blerësit e ardhshëm me certifikata të përkohshme. Ky regjistrim është i vlefshëm deri në regjistrimin e kontratës së shitjes, për efekt të kreditimit të blerësit. Për regjistrimin e kontratave paraprake zbatohet parimi i përparësisë së regjistrimit, sipas nenit 10 të këtij ligji.

Pas përfundimit të objektit, për regjistrimin përfundimtar të tij zbatohet neni 13 i ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.”.

Neni 18

Në nenin 44, shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) për një periudhë deri në 30 ditë nga data e njoftimit.”.

Neni 19

Në nenin 48 bëhen këto ndryshime:

a) Fjalja e parë ndryshohet si më poshtë:

“Regjistruesi korrigjon gabimet materiale në certifikatë, kartelën e pasurisë së paluajtshme dhe hartën treguese të regjistrimit në rastet e mëposhtme:”.

b) Pas shkronjës “dh” shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Kur regjistruesi vëren se në certifikatë ka gabime materiale, lëshon certifikatë të re, pasi të jetë depozituar certifikata e mëparshme e pronësisë.”.

Neni 20

Në nenin 51 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Vendimet dhe urdhrat e nxjerrë nga Kryeregjistruesi janë të detyrueshëm për zbatim nga regjistruesi.”.

Neni 21

Në nenin 55, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Çdo deklaram ose veprim, që bie në kundërshtim me nenet 11, 24, 44 dhe 45, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga regjistruesi nga 5 000 deri në 50000 lekë. Kundër vendimit të regjistruesit mund të bëhet ankim te Kryeregjistruesi brenda 30 ditëve. Kundër vendimit të Kryeregjistruesit ose mosmarrjes së tij, mund të bëhet ankim në gjykatën e rrethit ku është kryer kundërvajtja brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

Me ekzekutimin e gjobës ngarkohen strukturat e Policisë Tatimore.”.

Neni 22

Forma dhe përmbajtja e vendimeve që marrin regjistruesi dhe Kryeregjistruesi, në zbatim të këtij ligji, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 23

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të neneve 10, 14, 15 dhe 22 të këtij ligji.

Neni 24

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5262, datë 17.4.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

**LIGJ
Nr.9705, datë 2.4.2007**

**PËR FALJEN E KAMATËVONESAVE TË PAPAGUARA TË KONTRIBUTEVE TË
SIGURIMEVE TË DETYRUESHME SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ndërmarrjeve dhe shoqërive me kapital tërësisht shtetëror, institucioneve shtetërore, buxhetore e jobuxhetore, ndërmarrjeve dhe shoqërive me kapital të përbashkët me shtetin, personave juridikë e fizikë privatë dhe personave të vetëpunësuar në bujqësi u falen kamatëvonesat e kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, të papaguara deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kusht që detyrimet për kontributet të arkëtohen brenda datës 31.12.2007.

Kamatëvonesat e papaguara falen edhe kur kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore janë paguar para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 2

Pushohet ekzekutimi i vendimeve të gjykatave, që kanë marrë formë të prerë deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, për pjesën e kamatëvonesave të papaguara të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, të cilat falen me këtë ligj.

Neni 3

Kamatëvonesat e kontributeve për sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, të paguara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk kthehen.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5266, datë 17.4.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

**LIGJ
Nr.9706, datë 5.4.2007**

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8685, DATË 9.11.2000 “PËR NJË TRAJTIM TË
VEÇANTË TË PUNONJËSVE QË KANË PUNUAR NË MINIERA NË NËNTOKË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8685, datë 9.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar, bëhet shtesa si më poshtë:

Neni 1

Në fund të nenit 5 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Pagesa e trajtimit të veçantë ndërpritet për atë kohë sa personi përfiton të ardhura nga veprimtaria ekonomike si i punësuar ose i vetëpunësuar, me përjashtim të personave, të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomike si të vetëpunësuar në bujqësi e blegtori.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5267, datë 17.4.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

**LIGJ
Nr.9707, datë 5.4.2007**

**PËR KONTROLLIN SHTETËROR TË VEPRIMTARISË SË IMPORT- EKSPORTIT TË
MALLRAVE USHTARAKE DHE MALLRAVE E TEKNOLOGJIVE ME PËRDORIM TË
DYFISHTË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj rregullon veprimtarinë e kontrollit shtetëror mbi eksportin, importin, kalimin tranzit, transferimin dhe veprimtaritë ndërmjetësuese për mallrat ushtarake dhe mallrat e teknologjitë me përdorim të dyfishtë, për sigurimin e interesave kombëtarë të Republikës së Shqipërisë, mbikëqyrjen e respektimit të angazhimeve të saj në traktatet ndërkombëtare për mospërhapjen e armëve të dëmtimit në masë dhe sistemet e lëshimit të tyre, transferimin e armëve konvencionale, si dhe për zbatimin e masave, që synojnë parandalimin e përdorimit të këtyre mallrave nga terroristë dhe grupe të tjera për qëllime të kundërligjshme.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Transferim ndërkombëtar i mallrave” është eksportimi, importimi, riekportimi i mallrave, lëvizja e përkohshme e tyre, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kalimi tranzit i mallrave përmes territorit të saj dhe ndonjë transfertë tjetër mallrash jashtë këtij territori, në të cilën

janë përfshirë subjekte të ndryshme.

2. “Eksport” është:

a) shitja ose transferimi i ligjshëm i mallrave një subjekti të huaj, që ushtron veprimtari ekonomike ose veprimtari të tjera, me ose pa lëvizjen e mallrave jashtë kufijve doganorë të Republikës së Shqipërisë, si dhe rieksporimi i mallrave, përfshirë këtu shitjen ose transferimin e mallrave një përfaqësuesi diplomatik të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë ose një përfaqësuesi të çfarëdo subjekti ligjor të huaj, qytetar me shtetësi të huaj ose pa shtetësi;

b) shitja ose transferimi i së drejtës së kontrollit mbi mallrat në territorin e Republikës së Shqipërisë ose jashtë kufijve të saj një subjekti ligjor të huaj ose përfaqësuesit të tij, një personi me shtetësi të huaj ose pa shtetësi, përfshirë këtu realizimin e saj edhe nëpërmjet rrugëve e mënyrave të ndryshme të komunikimit;

c) ekspozimi, zbulimi i teknologjisë të një i huaj ose person pa shtetësi;

ç) transportimi faktik i mallrave për transferimin e tyre të mëtejshëm ose lëvizjen jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë.

3. “Embargo (e plotë ose e pjesshme)” është masa ndaluese ose kufizime të eksportit të mallrave për në vende të identifikuar si të tilla nga organizatat ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është anëtare, ose si pasojë e vendimeve të marra për shkak të ndjekjes së politikave të caktuara kombëtare.

4. “Import” është blerja ose përfitimi tjetër i ligjshëm i mallrave nga biznese apo subjekte të tjera të huaja, me ose pa lëvizjen (hyrjen) e tyre për në Republikën e Shqipërisë, përfshirë këtu blerjet për përdorim të brendshëm nga filiale dhe përfaqësues të institucioneve të shtetit shqiptar, organizatave, përfaqësive diplomatike dhe konsullore jashtë shtetit.

5. “Rieksporimi” është shitja e mallrave, që janë importuar më parë në territorin e Republikës së Shqipërisë ose transferimi i këtyre mallrave në mënyra të tjera të ligjshme subjekteve të huaja, me ose pa lëvizje të tyre jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

6. “Tranzitim” është lëvizja e mallrave nga një shtet i huaj te një tjetër përmes territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, ndërmjet dy pikave të hyrjes dhe të daljes ose me anë të një kalimi të vetëm të kufirit të shtetit shqiptar, me përjashtim të rasteve kur e drejta e pronësisë ose e përdorimit të këtyre mallrave, gjatë kësaj lëvizjeje të ligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, kalon nga një person te një tjetër.

7. “Eksportim i përkohshëm i mallrave” është lëvizja e mallrave nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë për në një shtet të huaj për rikthim të mëvonshëm në vendin e nisjes.

8. “Importim i përkohshëm i mallrave” janë lëvizjet e mallrave nga një shtet i huaj për në Republikën e Shqipërisë për lëvizjen e mëvonshme të tyre jashtë territorit të saj.

9. “Mallrat dhe teknologjitë” janë mallrat dhe teknologjitë e paracaktuara për qëllime ushtarake dhe për përdorim të dyfishtë.

Mallrat dhe teknologjitë e paracaktuara për qëllime ushtarake, veçmas apo të bashkuara me një mall tjetër, janë:

a) produktet e paracaktuara për qëllime ushtarake, si armatime, municione, hardware (pjesë elektronike) të prodhuara për qëllime të veçanta ose ushtarake apo pjesë specifike për prodhimin e tyre, eksplozivë, materialet dhe pajisjet e veçanta, të projektuara për zhvillimin, prodhimin dhe përdorimin e produkteve të tilla;

b) shërbimet e paracaktuara për qëllime ushtarake, si: shërbime që u sigurohen personave juridikë ose fizikë, brenda ose jashtë vendit, përfshirë edhe shërbimet ndërmjetësuese në fushën e projektimit, prodhimit, ndërtimit, montimit, testimit, riparimit, shërbimit teknik, përmirësimit, modernizimit, funksionimit, menaxhimit, demilitarizimit, marketingut, magazinimit, ekspozimit, identifikimit, përfitimit ose përdorimit të produkteve apo teknologjive të përdorimit ushtarak, si dhe dhënien e tyre subjekteve juridike të huaja ose përfaqësuesve të tyre apo personave për shërbime që kanë lidhje me financimin e veprimtarive të mësipërme;

c) teknologjitë e paracaktuara për qëllime ushtarake, si: informacioni i veçantë, në çdo formë (me përjashtim të informacionit të hapur për publikun), i nevojshëm për zhvillimin, prodhimin ose përdorimin e produkteve të paracaktuara për qëllime ushtarake, si dhe furnizimi i shërbimeve me karakter ushtarak. Një informacion i tillë mund të jetë në formën e të dhënave teknike ose të asistencës teknike.

10. “Të dhëna teknike” janë projektet, planet, skicat, skemat, diagramat, modelet, formulat,

specifikimet, software-t, manualët dhe udhëzuesit, të printuara në letër ose të regjistruara në mjete të tjera të ruajtjes së informacionit, përfshirë dhe ato elektronike.

11. “Asistencë teknike” është dhënia e udhëzimeve dhe e këshillimeve, si dhe marrja e masave për përmirësimin e kualifikimit, arsimimit e të metodave të punës dhe për rritjen e mëtejshme të përvojës.

12. “Teknologjitë bazë” janë teknologjitë që përcaktojnë parimet dhe mënyrat e punës, elementet përbërëse të tyre, pa të cilat pajisjet ushtarake nuk mund të prodhohen ose të përdoren.

13. “Mallra me përdorim të dyfishtë” janë lloje produktesh të veçanta, pajisje, materiale, software dhe teknologji, që nuk janë të projektuara posaçërisht për qëllime ushtarake, si dhe për punë e shërbime të lidhura me to, të cilat, përveç përdorimit civil, mund të përdoren për qëllime ushtarake ose terroriste apo në projektimin, prodhimin, përdorimin e armëve të paracaktuara për qëllime ushtarake, armëve të shkatërrimit në masë, mënyrat e përhapjes së tyre ose e pajisjeve eksplozive, bërthamore, përfshi këtu disa lloje materialesh bërthamore, agjentë kimikë, bakterologjikë, biologjikë dhe përgatitja toksike.

14. “Përdoruesit e fundit” janë personat juridikë ose fizikë vendas, strukturat shtetërore të Republikës së Shqipërisë, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, subjektet e zbatimit të ligjit, bizneset e huaja dhe subjektet e tjera, që janë konsumatorë të drejtpërdrejtë të mallrave të importuara në Shqipëri ose të eksportuara nga Shqipëria.

15. “Përdorim i fundit ushtarak” është përdorimi i një malli për projektimin, prodhimin, montimin, testimin, riparimin, shërbimin teknik, modifikimin, përmirësimin, shfrytëzimin, blerjen ose përdorimin e mallrave të projektuara për qëllime ushtarake, si:

a) përfshirja e mallrave të tilla në listën e mallrave të paracaktuara për qëllime ushtarake;

b) përdorimi i procesit të prodhimit, testimit të pajisjeve teknologjike dhe të përbërësve të tyre;

c) përdorimi i çdo komponenti të mallrave e të pajisjeve të përmendura, materialeve, software dhe teknologjive, ose garantimi i shërbimeve në këtë funksion.

16. “Subjektet që kryejnë transferime ndërkombëtare mallrash” janë subjekte me veprimtari tregtare në Republikën e Shqipërisë, të regjistruara në mënyrë të rregullt nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dhe përfaqësuesit e tyre, persona fizikë ose juridikë, që kanë si qëllim kryerjen e transferimeve ndërkombëtare, përfshirë edhe shërbimet ndërmjetësuese.

17. “Licencë” është dokumenti ligjor, i lëshuar nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, me anë të të cilit i lejohet një subjekti të kryejë transferime ndërkombëtare të mallrave, përfshirë të drejtën e eksportit ose të importit. Licenca mund të jetë e vlefshme për një përdorim, e përgjithshme ose e pakufizuar.

18. “Autorizim” është dokumenti ligjor, i lëshuar nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, që i jep një subjekti të licencuar për kryerjen e transferimeve ndërkombëtare të mallrave të drejtën për import dhe eksport të përkohshëm të mallrave ose tranzitim të tyre, për kryerjen e negociatave për nënshkrimin e një marrëveshjeje ekonomike të huaj/kontratë, në transferimet ndërkombëtare të mallrave të projektuara për qëllime ushtarake ose eksportin e mallrave me përdorim të dyfishtë dhe të mallrave të tjera të destinuara për në shtetet që janë objekt i embargos së pjesshme për këto mallra.

Autorizimi mund të jetë i vlefshëm për një rast, i përgjithshëm ose i pakufizuar.

19. “Licencë ose autorizim me një përdorim” është licenca ose autorizimi, lëshuar një subjekti të përfshirë në transferime ndërkombëtare të mallrave, për të kryer negociimet e nevojshme ose për të kryer një transfertë të veçantë ndërkombëtare të mallrave të një përdoruesi i fundit, i identifikuar, duke përcaktuar përshkrimin e mallit, sasinë, vlerën, kushtet e veçanta të shpërndarjes, emrin e biznesit të huaj ose të një subjekti tjetër, shtetin e destinacionit ose të origjinës së mallit dhe të përdoruesit të fundit.

20. “Licencë ose autorizim i përgjithshëm” është licenca ose autorizimi, lëshuar një subjekti të përfshirë në transferime ndërkombëtare të mallrave për zhvillimin herë pas here të negociatave ose për kryerjen e transferimit ndërkombëtar të mallrave të një përdoruesi i fundit, i identifikuar, duke përshkruar mallin, kushtet e veçanta të shpërndarjes, emrin e biznesit të huaj ose të subjekteve të tjera, vendin e destinacionit ose të përdoruesit të fundit.

21. “Licencë ose autorizim i pakufizuar” është licenca ose autorizimi, lëshuar një subjekti të përfshirë në transferime ndërkombëtare të mallrave për zhvillimin herë pas here të negociatave ose për

kryerjen e transferimit të mallrave, me shënimin vetëm për përshkrimin e mallit, kushtet e veçanta të shpërndarjes, emrin e shtetit të destinacionit ose të origjinës së mallit.

22. “Kontroll shtetëror i eksportit” është tërësia e masave që merren nga Autoriteti Shtetëror i Kontrollit të Eksporteve dhe organet e tjera shtetërore për ushtrimin e kontrollit shtetëror mbi transferimet ndërkombëtare të mallrave, përdorimin e tyre nga personat juridikë apo fizikë për qëllime të sigurisë kombëtare dhe të përmbushjes së angazhimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë.

23. “Sistem ndërinstitutional i kontrollit të eksporteve” është tërësia e masave organizative, ligjore, informative dhe masave të tjera që merren nga institucionet shtetërore ndaj një subjekti të përfshirë në transferimet ndërkombëtare të mallrave, për vëzhgimin e tij për të garantuar nëse veprimtaria është në përputhje me legjislacionin për kontrollin e eksportit.

24. “Veprimtari ndërmjetësues” (brokerage) është çdo veprim i kryer nga një subjekt tregtar i Republikës së Shqipërisë, person juridik ose fizik, që mundëson (ndërmjetëson) kryerjen e transferimeve ndërkombëtare të mallrave, të projektuara për qëllime ushtarake, përfshirë veprimet për financimin, transportin e dërgesave, pavarësisht origjinës së këtyre mallrave dhe territorit në të cilin do të kryhet kjo veprimtari.

25. “Dokument i garancisë” është dokumenti i shkruar, që përmban konfirmimin me shkrim të organit të autorizuar shtetëror ose të një shteti të huaj për deklarimin e qëllimit të përdorimit të artikujve, që jepet në formën e një certifikate ndërkombëtare importi, certifikate shpërndarjeje ose ndonjë dokumenti tjetër që përmban një konfirmim të tillë, apo që siguron zotimin me shkrim të përdoruesit të fundit, i cili jepet në formën e certifikatës së përdoruesit të fundit.

26. “Certifikatë ndërkombëtare e importit” është dokumenti, i lëshuar nga autoriteti i kontrollit shtetëror të eksporteve i shtetit importues, që konfirmon zotimin e importuesit të importojë mallra në shtetin e tij dhe pas importit të mos i eksportojë apo të mos i dërgojë në një shtet tjetër, pa lejen e organit të lartpërmendur.

27. “Deklaratë doganore” është dokumenti i lëshuar nga autoriteti i kontrollit shtetëror të eksporteve i shtetit importues, që konfirmon se mallrat kanë hyrë në këtë shtet.

28. “Certifikatë e përdoruesit të fundit” është dokumenti, me anë të të cilit përdoruesi i fundit përcakton vendin e instalimit (përdorimit) dhe qëllimin e fundit të përdorimit të mallit, si dhe garanton se mallrat nuk do të përdoren ndryshe nga çfarë përcaktohet në certifikatë, se nuk do të transferohen te ndonjë subjekt tjetër në territorin e shtetit mbërritës, ose nuk do të rieksporthen pa lejen e organeve shtetërore përkatëse, përfshirë edhe garanci të tjera për mallrat e importuara, të parashikuara nga kushtet e marrëveshjes/kontratës ekonomike me jashtë ose sipas kërkesave të shtetit eksportues.

Neni 3

Fusha e veprimit të ligjit

1. Ky ligj rregullon marrëdhëniet juridike, që lindin për shkak të veprimtarive për transferimin ndërkombëtar të mallrave, përfshirë shërbimet e ndërmjetësimit, prodhimit, shkencës, bashkëpunimit teknik, demonstrimet e tyre në ekspozitat e panairit ndërkombëtare për qëllime reklamimi, testimi, marketingu dhe veprime të lidhura me to deri në përdorimin përfundimtar apo përdoruesin e fundit, të kryera në përputhje me procedurat e vendosura për subjektet e përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave.

2. Ky ligj nuk aplikohet për:

a) transferimin e mallrave, që kanë lidhje me veprimtaritë e Forcave të Armatosura ose të strukturave të tjera shtetërore të sigurisë të Republikës së Shqipërisë jashtë territorit të saj, ose me veprimtarinë e forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, të kryera në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilat sigurojnë mekanizmin e kontrollit shtetëror të lëvizjes së këtyre mallrave;

b) transfertat ndërkombëtare të anestezikëve (gazet anestezike mjekësore), të armëve sportive e të gjahut, të enëve për gazin, në eksportimin dhe importimin e armatimit personal të personelit të shërbimit ushtarak dhe të organeve të rendit e të sigurisë së brendshme shtetërore, që janë të pajisura me armë, sipas ligjit;

c) procedurat e kontrollit shtetëror për transferimet ndërkombëtare të eksportit të mallrave, që kanë si qëllim dhënien e asistencës ushtarake, në përputhje me kushtet e parashikuara në marrëveshjet e traktatet ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë bën pjesë, si dhe lëvizjen e mallrave jashtë

vendit për dhënien e ndihmës së emergjencës shteteve të huaja, kur kjo vendoset sipas ligjit.

Neni 4

Parimet e politikës shtetërore për kontrollin e eksportit

Politika shtetërore për kontrollin e eksportit bazohet në këto parime:

1. Përparësinë e interesit kombëtar: politik, ekonomik dhe ushtarak, mbrojtja e të cilit është i domosdoshëm për garantimin e sigurisë kombëtare.
2. Mbrojtjen e interesit politik, ekonomik dhe ushtarak të vendit.
3. Detyrimin e respektimit të angazhimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë për mospërhapjen e armëve të shkatërrimit në masë, mënyrat e përhapjes së tyre dhe sigurimin e kontrollit shtetëror gjatë transferimit ndërkombëtar të mallrave të paracaktuara për qëllime ushtarake dhe të mallrave me përdorim të dyfishtë, si dhe moslejimin e përdorimit të këtyre mallrave për akte terroriste dhe qëllime të tjera të paligjshme.
4. Ligjshmërinë.
5. Zbatimin e kontrollit të eksportit vetëm në masën e nevojshme për arritjen e qëllimit të tij.
6. Harmonizimin e procedurave dhe të rregullave të kontrollit shtetëror të eksportit me praktikat dhe normat ligjore ndërkombëtare.
7. Sigurimin e ndërveprimit me organizatat ndërkombëtare dhe shtetet e huaja në fushën e kontrollit shtetëror të eksporteve, për forcimin e sigurisë dhe të stabilitetit ndërkombëtar, përfshirë këtu mospërhapjen e armëve të shkatërrimit në masë dhe të sistemeve të tyre të përhapjes.

Neni 5

Metodat e zbatimit të kontrollit shtetëror të eksportit

Metodat e zbatimit të kontrollit shtetëror të eksporteve janë si më poshtë:

1. Identifikimi i mallrave, duke bërë krahasimin e mallrave në fakt me emërtimin e mallrave të listës së kontrollit të eksporteve.
2. Dhënia e licencës ose e autorizimit, që lejon kryerjen e transfertave ndërkombëtare të mallrave ose të negociatave për transferime të tilla.
3. Zbatimi i procedurave të kontrollit doganor për këto transferime mallrash, në përputhje me legjislacionin doganor në fuqi.
4. Zbatimi i sanksioneve për veprimtarinë e subjekteve tregtare të huaja, që shkelin procedurat e transferimeve ndërkombëtare të mallrave, të vendosura me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore për kontrollin e eksporteve.

Neni 6

Kompetencat për kontrollin e eksportit

1. Kuvendi vendos bazat ligjore të politikës për kontrollin e eksporteve.
2. Këshilli i Ministrave harton dhe zbaton politikën shtetërore për kontrollin e eksporteve.
3. Politika shtetërore në këtë fushë zbatohet edhe nga Autoriteti Shtetëror për Kontrollin e Eksporteve, ministrinë dhe subjektet e tjera shtetërore, që kanë kompetenca për kontrollin e eksporteve. Këto subjekte mund të angazhojnë organizma të tjerë shtetërorë gjatë zbatimit të masave të marra në procesin e kontrollit të eksportit, si përfaqësitë diplomatike e konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, me pëlqimin e institucionit të varësisë.
4. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo në bashkëpunim me organet e tjera qendrore ekzekutive:
 - a) nxit veprimtaritë për transfertat ndërkombëtare të mallrave, kur ato janë në përputhje me interesin kombëtar, duke i dhënë përparësi krijimit ose ruajtjes së vendeve ekzistuese të punës në fushën e teknologjisë së lartë;
 - b) kufizon/ndalon këto veprimtari, nëse bien në kundërshtim me interesin kombëtar, me angazhimet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, me angazhimet në luftën kundër terrorizmit, kur ka arsye të mendohet se këto mallra i përkasin armëve të dëmtimit në masë apo kanë si qëllim krijimin e armëve të tilla e të mjeteve të përhapjes së tyre, ose kur subjekti nuk është i pajisur me garancinë e përdoruesit të fundit të mallit.

Neni 7

Shkëmbimi i të dhënave në procesin e kontrollit shtetëror të eksportit

Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve ka të drejtë të marrë nga organet e tjera shtetërore dhe subjektet e tjera, në transferimet ndërkombëtare të mallrave, të gjitha të dhënat e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të veta për kontrollin e eksporteve. Këto të dhëna mund t'i përdorë dhe t'i shkëmbejë me agjencitë e tjera ndërkombëtare homologe, si dhe me homologë ndërkombëtarë, vetëm për qëllime të kontrollit të eksporteve dhe për mbrojtjen e interesave kombëtarë.

Shkëmbimi i informacionit për transferimet ndërkombëtare të mallrave nuk duhet të jetë në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe me interesat kombëtarë.

Neni 8

Konfidencialiteti i kontrollit

Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, gjatë veprimtarisë së vet, është i detyruar të ruajë konfidencialitetin për të dhënat e sekretet e subjekteve tregtare, objekt i kontrollit.

KREU II

BAZAT E ORGANIZIMIT DHE TË ZBATIMIT TË KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTIT

Neni 9

Autoriteti i kontrollit të eksporteve, importeve të mallrave ushtarake e të mallrave e teknologjisë me përdorim të dyfishtë

Në Ministrinë e Mbrojtjes funksionon Agjencia e Kontrollit Shtetëror të Eksport-Importeve të Mallrave Ushtarake, Mallrave e Teknologjive me Përdorim të Dyfishtë (që në këtë ligj do të quhet Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve).

Veprimtaritë tregtare me të huajt kryhen në bazë të licencave dhe të autorizimeve, të lëshuara nga ky autoritet pas marrjes së mendimit të institucioneve të interesuara.

Këshilli i Ministrave, me vendim, përcakton organizimin, përbërjen, funksionimin dhe statutin e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dhe procedurën e marrjes së miratimit të institucioneve të interesuara.

Neni 10

Lista e mallrave që janë objekt i kontrollit shtetëror të eksportit

Emërtimet dhe përshkrimet e mallrave që janë objekt i kontrollit shtetëror të eksporteve përfshihen në listën e mallrave, objekt i kontrollit.

Lista e mallrave hartohet nga organi shtetëror i autorizuar për kontrollin e eksporteve, me pjesëmarrjen e ministrive e të organeve të tjera të interesuara. Kjo listë duhet të jetë në përputhje të plotë me listën e mallrave me përdorim të dyfishtë të Bashkimit Europian dhe listat e regjimeve të tjera ndërkombëtare të armëkontrollit.

Këshilli i Ministrave miraton çdo vit listën e mallrave, që janë objekt i kontrollit shtetëror të eksportit.

Neni 11

Zbatimi i procedurave të kontrollit shtetëror të eksportit për ndalimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, mënyrat e përhapjes së tyre dhe të armëve konvencionale

Kur një organ qendror shtetëror ekzekutiv merr informacion për qëllimin ose mundësinë e përdorimit të ndonjë artikulli, që nuk përfshihet në listë në vendet që janë përdoruesit e fundit të tyre, për projektimin, prodhimin, montimin, testimin, riparimin, shërbimin teknik, modifikimin, përmirësimin, veprimin, drejtimin, menaxhimin, magazinimin, ekspozimin, identifikimin ose për përhapjen e armëve të dëmtimit në masë e të rrugëve të lëshimit të tyre, është i detyruar të informojë Autoritetin e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, i cili ka të drejtën e ushtrimit të procedurave të kontrollit shtetëror të eksporteve.

Kontrolli shtetëror i eksporteve zbatohet edhe për eksportin dhe lëvizjen e përkohshme të

mallrave, që nuk janë përfshirë në listën e kontrollit, në rastet kur:

1. Mallra të tilla importohen në territorin e Republikës së Shqipërisë, të shoqëruara me certifikatë ndërkombëtare të importit, të lëshuar nga autoriteti i shtetit eksportues, i cili kërkon një kontroll të tillë.

2. Eksporti ose lëvizja e përkohshme e mallrave të tilla jashtë Shqipërisë bëhet për në vendet nën embargo, të plotë ose të pjesshme, të shpallur në bazë të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, organizmave të tjerë ndërkombëtarë, ku Republika e Shqipërisë është anëtare ose nga legjislacioni kombëtar.

3. Një subjekt i përfshirë në veprimtaritë ekonomike me jashtë është informuar nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për mundësinë e përdorimit të plotë ose të pjesshëm të mallrave që eksportohen ose lëvizin përkohësisht te një shtet për projektimin, prodhimin, montimin, testimin, riparimin, shërbimin teknik, modifikimin, përmirësimin, veprimin, drejtimin, menaxhimin, magazinimin, ekspozimin, identifikimin ose për përhapjen e armëve të dëmtimit në masë e të rrugëve të lëvizjes së tyre, ose për përdorim të fundit ushtarak në vendet nën embargo, të pjesshme ose të plotë, sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, organizmave të tjerë ndërkombëtarë, ku Shqipëria është anëtare, ose legjislacionit kombëtar, atëherë ky subjekt është i detyruar t'i drejtohet Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për të marrë autorizim për ushtrimin e së drejtës së eksportit të këtyre mallrave, pa marrë parasysh nëse ato janë të përfshira në listë apo jo.

Neni 12

Ekspertiza në fushën e kontrollit shtetëror të eksportit

1. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve kryen ekspertizën në fushën e kontrollit shtetëror të eksporteve për zgjidhjen e çështjeve të licencave, autorizimeve ose certifikatës ndërkombëtare të importit, të mundësisë së regjistrimit të subjektit në veprimtaritë ekonomike me jashtë ose të dhënies së mundësisë së eksportit dhe të importit të mallrave të destinuara për qëllime ushtarake edhe nëse këto vlerësohen sekret shtetëror.

2. Ekspertë nuk mund të caktohen personat që kanë interesa në rezultatin e ekspertizës.

3. Kohëzgjatja e një ekspertize nuk duhet të kalojë 30 ditë nga data e sigurimit të të gjitha dokumenteve të nevojshme për organin e autorizuar shtetëror të kontrollit të eksporteve, nëse nuk është i nevojshëm bashkërendimi i punës me institucionet e tjera të interesuara.

Neni 13

Objektivat në fushën e kontrollit të eksportit

a) Vlerësimi i statusit të mbrojtjes së interesave të sigurisë kombëtare, mbajtja e angazhimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë për mospërhapjen e armëve të shkatërrimit në masë, mënyrat e përhapjes së tyre dhe kufizimin e transferimeve të armëve konvencionale, si dhe marrja e masave për shmangien e përdorimit të mallrave të lartpërmendura për qëllime terroriste dhe të kundërligjshme.

b) Vlerësimi i eksportit nëse në vendin që është përdoruesi i fundit ekziston mundësia e krijimit të armëve të shkatërrimit në masë, mënyrat e përhapjes së tyre, armët konvencionale, makinerive ushtarake, ose blerja e çdo artikulli tjetër që mund të përdoret për krijimin e armëve të shkatërrimit në masë ose për mënyrat e përhapjes së tyre.

c) Krahësimi i të dhënave në etiketën e mallit dhe në përshkrimin e tij, objekt i ekspertizës, me emërtimin e mallit e përshkrimin e tij në listën e mallrave, objekt i kontrollit shtetëror të eksporteve.

ç) Përcaktimi i origjinës së mallrave.

d) Vlefshmëria e garancisë për shpërndarjen e mallrave të përdoruesi i fundit, i deklaruar dhe përdorimi i tyre për qëllimet e deklaruara.

dh) Qëndrueshmëria e subjekteve të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave, sipas legjislacionit shqiptar për kontrollin e eksportit, si dhe prania e dokumenteve organizative në sistemin ndërinstitutional të kontrollit të eksportit në këto subjekte.

e) Përcaktimi i mundësisë së garantimit të lejes për subjektet e përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave, që u jep atyre të drejtën e import-eksportit, tranzitimit ose të kryerjes së

negociatave të pasuara me nënshkrimin e marrëveshjeve ekonomike me jashtë/kontratave për kryerjen e transferimeve ndërkombëtare të mallrave, si dhe revokimin e këtyre lejeve kur këto subjekte shkelin legjislacionin në fushën e kontrollit shtetëror të eksportit.

ë) Përcaktimi i mundësisë për garantimin e dhënies së certifikatave ndërkombëtare të importit të mallrave subjekteve të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave, si dhe të drejtën e revokimit të këtyre certifikatave kur shkelet legjislacioni në fushën e kontrollit të eksportit nga këto subjekte.

f) Vlerësimi i kushteve për regjistrim pranë Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve të subjekteve të krijuara sipas ligjit nr.7632, datë 4.11.1992 “Për dispozitat, që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar”, të cilat kanë për qëllim kryerjen e transferimit ndërkombëtar të mallrave, përfshirë këtu edhe subjektet tregtare, që synojnë të ushtrojnë veprimtari ndërmjetësimi për transferimet ndërkombëtare të mallrave, të destinuara për qëllime ushtarake.

g) Vlerësimi i mundësisë për paraqitjen e propozimeve në Këshillin e Ministrave, nëpërmjet Ministrit të Mbrojtjes, për t’u garantuar subjekteve të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave të drejtat për të eksportuar dhe importuar mallra të paracaktuara për qëllime ushtarake dhe mallra që vlerësohen sekret shtetëror.

gj) Përcaktimi i dokumentacionit shoqërues të mallrave, të tilla si: informacione që përbëjnë sekret shtetëror dhe niveli i sekretit të këtyre mallrave.

h) Përcaktimi i faktorëve të tjerë, që mund të lejojnë marrjen e vendimeve thelbësore në fushën e kontrollit të eksportit.

Neni 14

Regjistrimi i subjekteve të përfshira në transferimin ndërkombëtar të mallrave

Subjektet tregtare, që kanë qëllim të kryejnë transferime ndërkombëtare të mallrave, përfshirë ato që kërkojnë të angazhohen në veprimtari ndërmjetësimi në transferimet ndërkombëtare të mallrave, të destinuara për qëllime ushtarake, regjistrohen paraprakisht si subjekte të përfshira në këtë transferim edhe pranë Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, ku duhet të paraqesin të dhëna dhe dokumente të nevojshme për kryerjen e ekspertizës së mallrave.

Në bazë të rezultateve të ekspertizës, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve identifikon mallrat, përcakton kushtet e transferimit të tyre ndërkombëtar në shtete të veçanta dhe u lëshon këtyre subjekteve certifikatën e regjistrimit, si subjekte të përfshira në transferime ndërkombëtare mallrash, bashkë me sqarimet plotësuese përkatëse për veçoritë e transferimit ndërkombëtar të mallrave.

Subjekti tregtar, në ekspertizën e mallrave, mund të asistohet nga persona apo organe të licencuara për kryerjen e identifikimit paraprak të mallrave.

Subjekti tregtar mban përgjegjësi për moskryerjen e identifikimit paraprak të mallrave dhe të veprimeve të nevojshme për marrjen e licencës për transfertat ndërkombëtare të mallrave, si dhe për importimin e tyre pa dokumente nga Republika e Shqipërisë.

Procedurat e kryerjes së ekspertizës rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 15

Autoriteti për kryerjen e transferimit ndërkombëtar të mallrave

Subjektet tregtare, të përfshira në veprimtaritë ekonomike me jashtë për eksportimin e importimin e mallrave ushtarake, që vlerësohen sekret shtetëror, autorizohen nga Këshilli i Ministrave.

Këshilli i Ministrave përcakton me vendim procedurat për marrjen ose shfuqizimin e licencave për kryerjen e transferimeve ndërkombëtare të mallrave të përshkruara në këtë nen.

Neni 16

Organizimi i sistemit të kontrollit të eksportit ndërmjet subjekteve të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave

Subjektet e përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave, për të siguruar respektimin e legjislacionit për kontrollin e eksportit në të gjitha fazat e transferimit, mund të krijojnë një sistem

ndëroorganizativ të kontrollit të eksporteve me ndihmën e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

Vendosja e sistemit ndëroorganizativ të kontrollit të eksportit është e detyrueshme për subjektet tregtare të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave, të cilat, nëse dëshirojnë të pajisen me licencë të përgjithshme apo të pakufizuar, duhet të marrin më parë autorizim nga Këshilli i Ministrave për të eksportuar dhe importuar mallra të destinuara për qëllime ushtarake dhe mallra që vlerësohen sekret shtetëror.

Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve bën certifikimin e sistemit ndëroorganizativ të kontrollit të eksportit, të krijuar nga subjektet e përfshira në transferimin ndërkombëtar të mallrave dhe i pajis ato me certifikatën e nevojshme të sistemit.

Procedurat e certifikimit përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 17

Licencat dhe autorizimet

Licencat dhe autorizimet lëshohen nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për një rast, të përgjithshme ose të pakufizuara.

1. Licencat dhe autorizimet për një rast mund t'u lëshohen subjekteve tregtare, të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave për zhvillimin e negociatave për marrëveshje ekonomike/kontrata të veçanta me jashtë, për zbatimin e transferimit ndërkombëtar të mallrave ose zbatimin e transferimeve të veçanta të mallrave, në përputhje me marrëveshjet që përmenden më lart, që janë të vlefshme për një periudhë të përcaktuar, por jo më shumë se një vit. Ky afat mund të zgjatet nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, në bazë të aplikimit të subjektit, të përfshirë në transferimin e mallrave, por jo më gjatë se afati i vlefshmërisë së marrëveshjes ekonomike, që i referohet kjo licencë/autorizim.

2. Licencat dhe autorizimet e përgjithshme mund t'u lëshohen subjekteve, të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave, për zhvillimin herë pas here të negociatave për nënshkrimin e marrëveshjeve ekonomike me jashtë ose transferimin shumëherësh të përdoruesit e fundit të veçantë të parashikuar në marrëveshjen ekonomike me jashtë/kontratën, bërë gjatë kohës së vlefshmërisë së kësaj licence/autorizimi dhe është e vlefshme gjatë kësaj periudhe, por jo më shumë se tre vjet.

3. Licencat dhe autorizimet e pakufizuara mund t'u lëshohen subjekteve të përfshira në transferime ndërkombëtare të mallrave, nëse angazhohen herë pas here në negociata të planifikuara për nënshkrimin e një marrëveshjeje ekonomike me jashtë/kontratë, ose në rastet e transferimeve shumëherëshe të mallrave të përdoruesit e fundit të ndryshëm në një shtet të veçantë, sipas parashikimit në marrëveshjen/kontratën ekonomike me jashtë, të planifikuar për t'u kryer me importues të veçantë gjatë afatit të vlefshmërisë së licencës/ autorizimit, në kuadër të traktateve përkatëse ndërkombëtare ose transferime, në të cilat përfshihen shtetet që janë anëtare në regjimet ndërkombëtare të kontrollit të eksporteve ose objekt përkatës në politikën shtetërore dhe është e efektshme për periudhën e përcaktuar, por jo më shumë se tre vjet.

Kushtet detyruese për lëshimin e licencave dhe të autorizimeve të veçanta, të përgjithshme dhe të pakufizuara për subjektet e përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave, janë ruajtja e sistemit ndëroorganizativ të kontrollit të eksporteve të këtyre subjekteve, sigurimi i vëzhgimit të kërkesave të kontrollit të eksporteve në procesin e transferimeve ndërkombëtare të mallrave të veçanta, ruajtja e mbajtja e dokumentacionit që ka lidhje me këto transferime dhe paraqitja e raporteve përkatëse tek Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

Neni 18

Afatet e shqyrtimit të aplikimit për licencë/autorizim

Afatet për shqyrtimin e aplikimit, kur për dhënien e licencave dhe autorizimeve nuk kërkohet bashkërendimi i punës me institucionet e tjera të interesuara, duhet të përcaktohen në përputhje me kategoritë e mallrave, por nuk duhet të kalojnë afatet e përcaktuara më poshtë nga dita e aplikimit:

1. 45 ditë për eksportin (rieksportin) e mallrave ushtarake.

2. 30 ditë për eksportin (rieksportin) e mallrave të përdorimit të dyfishtë dhe eksportin e përkohshëm (importin e përkohshëm) të çdo malli.

3. 15 ditë për importin ose kalimin tranzit të mallrave, si dhe importin/eksportin e përkohshëm të mallrave për arsye ekspozimi, panaire, reklama, teste dhe qëllime të tjera të ngjashme, nëse ajo nuk parashikon transferimin e së drejtës së pronësisë.

Koha e nevojshme për të marrë informacion shtesë nga subjektet e përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave nuk është përfshirë në këtë afat.

Aplikimi për licencë apo autorizim vlerësohet i refuzuar dhe nuk është objekt shqyrtimi, nëse informacioni shtesë nuk mbërrin brenda dy muajve nga çasti i bërjes së kërkesës për aplikim.

Këshilli i Ministrave përcakton procedurat për zgjatjen e afatit të shqyrtimit të aplikimeve dhe mënyrën e procedimit të mëtejshëm.

Neni 19

Marrja e licencave, e autorizimeve dhe e garancisë shtetërore

Vendimet për dhënien e licencave dhe të autorizimeve ose certifikatave ndërkombëtare të importit merren nga organi i Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, në bazë të rezultateve të ekspertizës për kontrollin e eksportit.

Një subjekt i përfshirë në transferimet ndërkombëtare të mallrave ose një biznes i huaj apo subjekt tjetër, për marrjen e vendimit për dhënien e licencave e të autorizimeve ose të certifikatave ndërkombëtare të importit, i dërgon me shkrim Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve kërkesën, të shoqëruar me dokumentet e nevojshme për kryerjen e ekspertizës. Këto dokumente duhet të përmbajnë të dhëna të sakta për mallrat e procedurat e transferimit ndërkombëtar të tyre, si edhe garancinë origjinale për këto transferime, të paraqitura bashkë me kërkesën.

Rishikimi i kërkesave për dhënien e licencave, autorizimeve dhe certifikatave ndërkombëtare të importit kryhet nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve me pjesëmarrjen, nëse është e nevojshme, të organeve të tjera shtetërore, të subjekteve, institucioneve dhe strukturave të tjera, nëse çështjet që shqyrtohen janë brenda kompetencave të tyre.

Neni 20

Mosmarrja në shqyrtim dhe refuzimi i kërkesës

Kërkesa për dhënien e licencave, autorizimeve ose certifikatës ndërkombëtare të importit nuk do të merret në shqyrtim nëse:

- a) është bërë nga një person që nuk ka zotësi juridike;
- b) mungojnë dokumente ose ato janë formuluar në kundërshtim me kërkesat e nenit 19 të këtij ligji;
- c) ekzistojnë shkaqe të tjera, që bien në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi ose me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara.

Nëse kërkesa për dhënien e licencës, autorizimit dhe certifikatës ndërkombëtare të importit nuk merret në shqyrtim ose refuzohet, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve njofton aplikantin dhe organin shtetëror përgjegjës brenda tri ditëve pas marrjes së vendimit përkatës, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe arsyet e mosshqyrtimit apo të refuzimit.

Neni 21

Revokimi dhe pezullimi i kërkesave

Licencat, autorizimet dhe certifikatat ndërkombëtare të importit mund të revokohen ose të pezullohen nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve:

1. Në rastet e emergjencës, lidhur me nevojat dhe interesin e sigurisë kombëtare, ose për të zbatuar detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë.
2. Kur subjekti është në likuidim e sipër, sipas procedurave ligjore përkatëse.
3. Kur subjekti, i përfshirë në transferimin ndërkombëtar të mallrave, falimenton dhe ndaj tij zhvillohen procedurat ligjore përkatëse të falimentimit.
4. Kur është e nevojshme kryerja e një ekspertize shtesë nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve i dokumenteve të paraqitura nga subjekti, i përfshirë në transferimin ndërkombëtar të mallrave, i cili kërkon të pajiset me licencë, autorizim apo certifikatë ndërkombëtare importi.
5. kur vihet re se subjekti, i përfshirë në transferimet ndërkombëtare të mallrave, ka kryer

shkelje të legjislacionit, përfshirë legjislacionin për kontrollin e eksportit, përcaktuar në nenin 30 të këtij ligji.

Neni 22

Afati i ruajtjes së dokumentacionit

Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve mban dhe ruan për 10 vjet pas lëshimit të lejes, lejes së veçantë, certifikatës ndërkombëtare të importit ose refuzimit të kërkesës, kërkesat e dokumentet e tjera të paraqitura nga subjektet përkatëse.

Neni 23

Marrëveshjet ose kontratat me jashtë për transferimet ndërkombëtare të mallrave

1. Marrëveshjet ose kontratat ekonomike me jashtë, për transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të atyre me përdorim të dyfishtë, nënshkruhen me subjektet e përfshira në veprimtaritë ekonomike me jashtë, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe me politikat shtetërore, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave në këtë fushë.

2. Subjektet tregtare vendase, të përfshira në veprimtari ekonomike me jashtë, gjatë procesit të hartimit të këtyre marrëveshjeve apo kontratave dhe mënyrave të tjera të transferimit ndërkombëtar të mallrave, të parashikuara nga ky ligj, prezumohet se janë në dijeni se mallrat dhe artikujt, objekt i këtyre transferimeve (marrëveshje e kontrata), mund të përdoren nga shtete të tjera ose nga subjekte ekonomike të huaja për krijimin e armëve të dëmtimit në masë dhe mënyrave të përhapjes së tyre.

3. Një subjekt, i përfshirë në veprimtari ekonomike me jashtë, është i detyruar të refuzojë zbatimin e një marrëveshjeje/kontrate ekonomike të huaj për transferimin ndërkombëtar të mallrave, nëse ai njoftohet se mallrat do të përdoren për qëllime të tjera, të padeklaruara në marrëveshje/kontratë ose në dokumente të tjera të lidhura me këtë transferim, ose do të përdoren nga një përdorues tjetër i fundit, i ndryshëm nga ai për të cilin është lëshuar licenca/autorizimi.

KREU III

KONTROLLI SHTETËROR I VEPRIMTARIVE QË LIDHEN ME TRANSFERTAT NDËRKOMBËTARE TË MALLRAVE

Neni 24

Kontrolli shtetëror për kryerjen e negociatave për nënshkrimin e një marrëveshjeje ose kontrate ekonomike me jashtë

Një subjekt, i përfshirë në veprimtari ekonomike me jashtë, kryen negociata me një subjekt ekonomik të huaj, për nënshkrimin e një marrëveshjeje/kontrate ekonomike, për eksportin e mallrave të destinuara për qëllime ushtarake dhe për përdorim të dyfishtë, të një shteti të huaj, pjesërisht nën embargo, nëse merr autorizim nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

Procedurat e kontrollit shtetëror për këto negociata përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 25

Kontrolli shtetëror për përdorimin e fundit të mallrave

1. Një subjekt, i përfshirë në transferimet ndërkombëtare të mallrave, i paraqet Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve informacion të plotë e të saktë për përdorimin e fundit të mallrave, objekte të transferimit ndërkombëtar, si dhe kopje të garancisë origjinale për përdorimin e mallit, vetëm sipas qëllimit të deklaruar të përdorimit nga përdoruesi i fundit.

2. Subjektet e përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave marrin masa për verifikimin e mbërritjes së mallrave në destinacion e për përdorimin e fundit dhe, pas kryerjes së këtij verifikimi, i paraqesin Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve informacionin e duhur për kryerjen e verifikimeve të nevojshme.

3. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dhe organet e tjera shtetërore të autorizuar

kanë të drejtë që, në përputhje me procedurat e parashikuara në pikat 4, 5, 6 e 7 të këtij neni, të kryejnë verifikimin e mbërritjes në destinacion dhe të përdorimit të mallit në çdo fazë të transferimit ndërkombëtar edhe pas mbërritjes të përdoruesit i fundit.

4. Kontrolli shtetëror ndaj përdoruesve të fundit vendas, për mbajtjen e zotimeve për përdorimin e artikujve të importuar, sipas qëllimeve të deklaruara, ushtrohet në bazë të analizës së raporteve, të paraqitura nga subjekti, përdorues i fundit, për përdorimin aktual të mallrave, si dhe nëpërmjet kontrolleve të përzgjedhura të mallrave nga përdoruesi i fundit.

5. Kontrollat e tilla i kryejnë punonjësit e autorizuar nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

6. Në verifikimin e përdorimit aktual nga përdoruesi i fundit shqiptar të mallrave të importuara më parë nën garancinë shtetërore të përdorimit të tyre, sipas qëllimeve të deklaruara, mund të marrin pjesë edhe përfaqësues të eksportuesve të huaj ose të organeve shtetërore të shtetit eksportues, vetëm nëse është parashikuar në marrëveshjet apo kontratat ekonomike ose nëse kjo e drejtë rrjedh nga detyrimet e një marrëveshjeje ndërkombëtare, ku vendi eksportues dhe Republika e Shqipërisë janë palë.

7. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve mund të kryejë verifikimin e përdorimit nga përdoruesit e fundit të huaj të mallrave të importuara nga Shqipëria në territorin e vendeve të këtyre përdoruesve, nga subjekte të përfshira në veprimtari ekonomike me jashtë, nga subjekte të huaja ose entet e tjera, nën garancinë shtetërore të përdorimit për qëllimet e deklaruara, vetëm nëse është parashikuar në marrëveshjet apo kontratat ekonomike ose nëse kjo e drejtë rrjedh nga detyrimet e një marrëveshjeje ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë dhe vendi eksportues janë palë.

8. Procedurat e dhënies së garancive dhe të kryerjes së kontrollit shtetëror, në përmbushje të detyrimeve për përdorimin e mallit, objekt i kontrollit shtetëror të eksporteve, përfshirë dhënien e certifikatave ndërkombëtare të importit dhe të deklaratës doganore të mbërritjes në destinacion, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 26

Procedurat e kontrollit shtetëror të eksportit për transferimet ndërkombëtare të mallrave, në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare

Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve përdor procedura lehtësuese për të marrë në shqyrtim dhe për t'u siguruar nëse licencat dhe autorizimet për transferimet ndërkombëtare të mallrave (përfshirë shërbimet në zhvillimet teknologjike) janë dhënë në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare ose ndërqeveritare.

Zbatimi i procedurave lehtësuese për eksportuesit dhe përdoruesit e fundit bëhet në bazë të listës së mallrave, të përcaktuara në marrëveshjen ndërkombëtare ose ndërqeveritare.

Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve merr vendim për dhënien e licencës ose të autorizimit për një transferim ndërkombëtar mallrash brenda një afati prej 15 ditësh nga marrja në dorëzim e të gjitha dokumenteve të nevojshme, të paraqitura nga subjekti i përfshirë në këtë transferim.

Neni 27

Kontrolli doganor

Kontrolli doganor i mallrave dhe procedurat e tjera doganore kryhen në bazë të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë dhe të legjislacionit në fuqi për armët dhe mallrat e tjera me përdorim të dyfishtë.

Kontrolli doganor për mallrat, objekt i këtij ligji, bëhet në pikat e posaçme doganore.

Autoritetet doganore vendase, me kërkesën e importuesit të mallit, japin deklaratën doganore, ku konfirmohet fakti i mbërritjes së mallrave të kontrolluara.

Neni 28

Kontrolli shtetëror për përdorimin e licencave, autorizimeve dhe certifikatave ndërkombëtare të importit

Subjektet e përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave, që kanë marrë licencë, autorizim dhe certifikatë ndërkombëtare importi, paraqesin tek Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve raport me shkrim për kryerjen, në fakt, të transferimeve të mallrave të përmendura në këto dokumente dhe për përdorimin e këtyre mallrave sipas qëllimit të deklaruar.

Formati i raportit, afatet dhe koha e paraqitjes së tyre përcaktohen nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

Një subjekt, i përfshirë në transferimet ndërkombëtare të mallrave, me kërkesën e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, paraqet dokumentet dhe informacionin e nevojshëm për veprimtarinë e tij në fushën e kontrollit të eksporteve, përfshirë këtu dokumentet e garancisë, certifikatat teknike dhe dokumente të tjera, për nënshkrimin dhe zbatimin e një marrëveshjeje/kontrate ekonomike me jashtë në transferimet ndërkombëtare të mallrave. Ky subjekt është i detyruar t'i ruajë dhe t'i mbajë për 10 vjet këto dokumente.

KREU IV

PARANDALIMI I SHKELJEVE DHE PËRGJEGJËSITË PËR KONTROLLIN E EKSPORTIT

Neni 29

Parandalimi i shkeljeve të legjislacionit dhe përgjegjësia për kontrollin shtetëror të eksportit

Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dhe organet e tjera shtetërore, brenda kompetencave ligjore, për parandalimin e shkeljeve të legjislacionit në fushën e kontrollit shtetëror të eksportit, kanë të drejtë të kryejnë verifikime për shkeljet e legjislacionit në fushën e kontrollit shtetëror të eksportit, përfshirë edhe kontrollin e mbërritjes në destinacion të mallit, korrespondencën, dokumentet për objektivat e deklaruar, si dhe dokumente të tjera, mbi të cilat bazohet transferimi ndërkombëtar i mallrave.

Kur organi shtetëror vëren shkeljet e parashikuara në nenin 30 të këtij ligji, njofton menjëherë Autoritetin e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

Kur ka të dhëna të mjaftueshme se po përgatitet për t'u kryer një vepër penale ose kur ajo është kryer në fakt nga ndonjë subjekt, kur në të janë të përfshira edhe mallra, që janë objekt i kontrollit shtetëror të eksportit, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve njofton autoritetin e ndjekjes penale.

Neni 30

Shkeljet e legjislacionit në fushën e kontrollit shtetëror të eksportit

Kur nuk përbëjnë vepër penale, të parashikuar nga Kodi Penal, përbëjnë kundërvajtje administrative shkeljet e mëposhtme:

1. Kryerja e transferimit ndërkombëtar të mallrave pa u pajisur me licencë, autorizim dhe garanci shtetërore, sipas procedurave ligjore.

2. Kryerja e transferimit ndërkombëtar të mallrave, në bazë të licencave, autorizimeve e garancive shtetërore, të lëshuara në bazë të dokumenteve false ose që përmbajnë informacion të rremë.

3. Nënshkrimi i marrëveshjeve/kontratave ekonomike për transferimin ndërkombëtar të çfarëdolloj malli ose pjesëmarrja në zbatimin e tyre, në një mënyrë që nuk është përcaktuar nga ky ligj, kur subjekti i përfshirë në këtë transferim ka marrë informacion se mallrat do të përdoren nga vendi ose subjekti i huaj për krijimin e armëve të shkatërrimit në masë, si dhe për mënyrat e përhapjes së tyre.

4. Ndryshimi i destinacionit të mallrave në transferimet ndërkombëtare të mallrave dhe përdorimi për qëllime të ndryshme apo nga përdorues të fundit, të tjerë, të ndryshëm, nga ç'është deklaruar në marrëveshjen/kontratën ekonomike me jashtë dhe në dokumentet e tjera që lidhen me të, në bazë të të cilave është lëshuar licenca, autorizimi dhe certifikata ndërkombëtare e importit.

5. Fshehja e qëllimshme e informacionit, që mund të ndikojë në marrjen e vendimeve për dhënien e licencës, autorizimit dhe certifikatës ndërkombëtare të importit.

6. Kryerja e transferimeve ndërkombëtare të mallrave në kundërshtim me kushtet e parashikuara në licencën, autorizimin ose certifikatën ndërkombëtare të importit, përfshirë ndërhyrjen dhe bërjen e ndryshimeve në marrëveshjen/kontratën ekonomike të huaj pa dijeninë e Autoritetit të

Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, me emrat dhe kushtet e eksportuesit, importuesit, ndërmjetësit, përdoruesit të fundit, si dhe përshkrimit të mallrave, zotimet për përdorimin e fundit dhe dhënien e garancive.

7. Kryerja e negociatave pa autorizimin e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për nënshkrimin e marrëveshjeve/kontratave ekonomike për eksportin e mallrave ushtarake dhe të atyre me përdorim të dyfishtë për në një shtet, i cili është pjesërisht nën embargo.

8. Mosparaqitja ose paraqitja me vonesë e raporteve dhe e dokumenteve përkatëse tek Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për negociatat e përmendura në pikën 7 të këtij neni, për kryerjen e transferimit ndërkombëtar të mallrave ushtarake dhe të atyre me përdorim të dyfishtë, në bazë të licencës së marrë ose të autorizimit të veçantë, si dhe për mënyrën e përdorimit të këtyre mallrave, sipas qëllimit të deklaruar.

9. Krijimi i pengesave në ushtrimin e detyrës zyrtare nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dhe organet e tjera shtetërore, që kryejnë kontrollin shtetëror të eksporteve, sipas kompetencave ligjore që u jep ky ligj.

10. Refuzimi pa shkak për dhënien e informacionit dhe të dokumenteve të kërkuara nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve ose nga ndonjë organ tjetër, që kryen kontrollin shtetëror të eksportit brenda kompetencave të tij ligjore, shtrembërimi me dashje ose fshehja e tyre.

11. Shkatërrimi i qëllimshëm i dokumenteve, që lidhen me nënshkrimin dhe zbatimin e marrëveshjeve/kontratave ekonomike me jashtë për transferimin ndërkombëtar të mallrave, në bazë të të cilave janë lëshuar licencat, autorizimet ose certifikatat e importit ndërkombëtar, përpara afatit të parashikuar në nenin 26 të këtij ligji.

Neni 31

Përgjegjësia e subjekteve ligjore për shkeljen e legjislacionit në fushën e kontrollit të eksportit

Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve vendos gjoba ndaj subjekteve tregtare, të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave, si më poshtë:

1. Për shkeljet e parashikuara në pikat 1, 2 e 3 të nenit 30 të këtij ligji, në masën deri në 150 për qind të çmimit të mallrave, që ishin objekt i transferimit ndërkombëtar.

2. Për shkeljet e parashikuara në pikat 4, 5 e 6 të nenit 30 të këtij ligji, në masën deri në 100 për qind të çmimit të mallrave, që ishin objekt i transferimit ndërkombëtar.

3. Për shkeljet e parashikuara në pikat 7 e 11 të nenit 30 të këtij ligji, në masën deri në 1 000 për qind të minimumit të të ardhurave vjetore të pataksueshme të shtetasve.

4. Për shkeljet e parashikuara në pikën 8 të nenit 30 të këtij ligji, në masën deri në 500 për qind të minimumit të të ardhurave vjetore të pataksueshme të shtetasve.

5. Për shkeljet e parashikuara në pikat 9 e 10 të nenit 30 të këtij ligji, në masën deri në 100 për qind të minimumit të të ardhurave vjetore të pataksueshme të shtetasve.

Neni 32

Shfuqizimi e revokimi i licencës/autorizimit

Përveç vendosjes së gjobave të parashikuara në nenin 31 të këtij ligji, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve mund të revokojë licencën, autorizimin dhe certifikatën ndërkombëtare të importit, dhënë këtyre subjekteve, ose të bëjë çregjistrimin e këtyre subjekteve.

Në rastin kur një subjekt ligjor, i përfshirë në transferimin ndërkombëtar të mallrave, i cili ka të drejtën e importit, eksportit të mallrave ushtarake dhe atyre me përdorim të dyfishtë, që përbëjnë sekret shtetëror, kryen shkeljet e parashikuara në pikat 1 deri në 6 të nenit 30 të këtij ligji, ose në rastet kur, si pasojë e kësaj shkeljeje, ka pasur dëmtim të ndjeshëm të interesave politikë dhe ekonomikë të shtetit, Këshilli i Ministrave, me propozimin e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, nëpërmjet Ministrit të Mbrojtjes, shfuqizon garancinë e dhënë këtij subjekti. Ky akt është i paankimueshëm në gjykatë.

Neni 33

Ankimi kundër vendimeve të Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve

Vendimi i Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për revokimin e licencës, autorizimit dhe certifikatës ndërkombëtare të importit ose çregjistrimin e subjektit, të përfshirë në

veprimtari ekonomike me jashtë, për transferimin ndërkombëtar të mallrave, përveç rastit të parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 32 të këtij ligji, mund të ankimohet në gjykatën e apelit, sipas rregullave të përgjithshme të ankimit. Ankimi ndaj vendimit nuk e pezullon ekzekutimin e tij.

Shteti shqiptar nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj subjektit për humbjet e shkaktuara nga shfuqizimi ose revokimi i licencës, autorizimit, certifikatës ndërkombëtare të importit dhe garancisë shtetërore, ose kur këto veprime ndërmerren në mbrojtje të interesave kombëtarë dhe të përmbushjes së detyrimeve ndërkombëtare të shtetit.

Neni 34

Autoriteti i dhënies së gjobave për shkeljet e legjislacionit në fushën e kontrollit shtetëror të eksportit

Gjobat e parashikuara nga neni 30 i këtij ligji, në emër të Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, vendosen nga drejtuesi i tij.

Kur personi i autorizuar i Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve vëren një rën nga shkeljet e parashikuara në nenin 30 të këtij ligji, harton një relacion, të cilit i bashkëlidhen shpjegimet e drejtuesit të subjektit që ka bërë shkeljen e të zyrarëve të tjerë përgjegjës, si dhe dokumentet e tjera të nevojshme që vërtetojnë shkeljen, të cilat ia paraqet titullarit të autoritetit të përmendur në paragrafin e parë të këtij neni.

Drejtuesi i Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve ose zëvendësi i tij, brenda 10 ditëve pas marrjes së dokumenteve të përmendura në paragrafin e dytë të këtij neni, merr vendim për vënien e gjobës, në përputhje me këtë ligj.

Vendimi për vënien e gjobës hartohet në tri kopje. Një kopje i dorëzohet brenda tri ditëve, kundrejt nënshkrimit, drejtuesit ose personit të autorizuar të subjektit të përfshirë në transferime ndërkombëtare të mallrave, tranzitim apo ndërmjetësim, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi, ndërsa dy kopjet e tjera i mban organi që e ka vënë gjobën.

Relacioni dhe vendimi miratohen nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

Gjopa paguhet nga subjekti brenda 15 ditëve nga data e vënies së saj.

Vendimi mund të ankimohet në gjykatë brenda 15 ditëve nga data e marrjes së tij.

Gjopa përbën titull ekzekutiv, i cili ekzekutohet nga zyra e përmbartimit, nëse nuk shlyhet vullnetarisht brenda afatit ose për të nuk bëhet ankim në gjykatë.

Neni 35

Përgjegjësia e personave të përfshirë në transferimet ndërkombëtare të mallrave për shkelje të legjislacionit në fushën e kontrollit shtetëror të eksportit

Subjektet e përfshira në veprimtari ekonomike me jashtë, personat fizikë, që shkelin legjislacionin në fushën e kontrollit shtetëror të eksportit, sipas shkeljes së kryer, mbajnë përgjegjësi administrative e civile, sipas përcaktimeve në këtë ligj.

Neni 36

Përgjegjësia e personelit për shkeljet e legjislacionit në fushën e kontrollit shtetëror të eksportit

Personeli i Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dhe i organizmave të tjerë shtetërorë, të përfshirë në vendimmarrjen në këtë fushë, për shkelje të legjislacionit në fuqi, mban përgjegjësi administrative e civile, sipas përcaktimeve në këtë ligj.

KREU V

MBËSHTETJA FINANCIARE PËR KONTROLLIN SHTETËROR TË EKSPORTIT

Neni 37

Financimi i veprimtarisë së kontrollit shtetëror të eksportit

Shpenzimet e veprimtarive të kontrollit shtetëror të eksportit përballohen nga Buxheti i Shtetit.

Neni 38

Mbledhja e tarifave për regjistrimin dhe dhënien e dokumenteve

Për dhënien e dokumenteve të regjistrimit subjekteve të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave, të licencës, autorizimit dhe certifikatës ndërkombëtare të importit apo të deklaratës doganore, që konfirmon mbërritjen e mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë, paguhet një tarifë, e cila derdhet në Buxhetin e Shtetit.

Vlera e tarifave të përmendura në paragrafin e parë të këtij neni përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

**KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT**

Neni 39

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda gjashtë muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor për krijimin e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, si dhe të përgatisë e të miratojë aktet e tjera nënligjore në zbatim të neneve 6, 9, 10, 13, 14, 15, 16, 24, 25 e 38 të këtij ligji.

Neni 40

Shfuqizime

Të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që bien në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 41

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 qershor 2007.

Shpallur me dekretin nr.5269, datë 17.4.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

**LIGJ
Nr.9708, datë 5.4.2007**

**PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.7703, DATË 11.5.1993 “PËR SIGURIMET SHOQËRORE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në fund të paragrafit të dytë të nenit 2 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Kur standardi minimal i jetesës nuk arrihet nga pensioni bazë, Këshilli i Ministrave ka të

drejtë të vendosë një shtesë të ardhurash në formë kompensimi.”.

Neni 2

Në fund të fjalisë së parë të pikave 1 e 2 të nenit 88 shtohen fjalët “dhe kompensimit, sipas paragrafit të dytë të nenit 2”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5268, datë 17.4.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ

Nr.9710, datë 10.4.2007

PËR PORTET TURISTIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe i kriterëve që zbatohen për ndërtimin, funksionimin dhe administrimin e porteve turistike, për trafikun ndërkombëtar dhe kombëtar e të pontileve të përhershme dhe të përkohshme.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për portet turistike përgjatë vijës bregdetare dhe në ujërat e brendshme të lundrueshme të Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj, termit e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Port” është një pjesë e territorit tokësor të bregdetit, territorit detar, liqenor dhe ujqor, i përcaktuar për të pranuar mjete lundruese.
2. “Pontile” janë zgjatime të bregut, të përgatitura posaçërisht për akostimin e mjeteve lundruese.
3. “Administrata e portit turistik” është personi juridik, i cili ka fituar të drejtën e krijimit dhe të administrimit të portit turistik, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore.

4. “Ujëra të brendshme, të lundrueshme” janë të gjitha ujërat e liqeneve dhe të lumenjve, të përshtatshme për lundrimin e mjeteve turistike.

5. “Lundrime turistike” janë lundrimet që kryhen me qëllim argëtues, zbavitës, njohës e sportiv.

6. “Mjete për lundrime turistike” janë mjete të caktuara për kryerjen e veprimtarisë turistike dhe të regjistruara si të tilla në regjistrat përkatës.

7. “Operatorë turistikë” janë të gjitha ato subjekte juridike, që veprojnë në fushën e turizmit ujqor dhe që kanë fituar të drejtën e ushtrimit të kësaj veprimtarie nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 4

Klasifikimi i porteve turistike

Portet dhe pontilet turistike klasifikohen në:

- a) porte turistike për trafikun ndërkombëtar;
- b) porte turistike për trafikun kombëtar;
- c) pontile të përhershme;
- ç) pontile të përkohshme.

Neni 5

Veprimtaritë e lejuara në portet turistike

Në portet turistike për trafik ndërkombëtar dhe kombëtar lejohet të kryhen veprimtaritë e mëposhtme:

1. Qëndrimi i përkohshëm i mjeteve lundruese turistike.
2. Parkimi i mjeteve lundruese turistike në vendet e caktuara, brenda hapësirës ujore dhe tokësore të portit.
3. Mirëmbajtja e mjeteve lundruese turistike.
4. Veprimtaria e operatorëve turistikë.
5. Shërbimi i akomodimit dhe i shërbimeve të tjera në funksion të turizmit.
6. Veprimtari të tjera turistike, të përcaktuara me akte ligjore dhe nënligjore.

Veprimtaritë e lejuara dhe mënyra e rregullimit të tyre në portet turistike përcaktohen në rregulloret e përgjithshme dhe/ose specifike, të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 6

Mënyra e ndërtimit të porteve turistike

Ndërtimi me koncesion i porteve turistike për trafik ndërkombëtar dhe kombëtar, si dhe i pontileve të përhershme bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për koncesionet.

Leja e ndërtimit të tyre jepet nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar.

Leja e ndërtimit të pontileve të përkohshme jepet nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar.

Neni 7

Ndërtimi i porteve turistike

Portet turistike dhe pontilet e përhershme ndërtohen në vendet e përcaktuara nga studimet dhe/ose masterplanet e miratuara nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë.

Portet turistike dhe pontilet e përhershme ndërtohen sipas parametrave të përcaktuar në manualin teknik të ndërtimit të porteve turistike. Manuali teknik dhe kriteret miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për portet.

Neni 8

Shpallja e porteve turistike

Shpallja e porteve turistike të hapura për trafik ndërkombëtar dhe kombëtar, si dhe e pontileve të përhershme bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për portet, në mbështetje të pikave 6 e 7 të nenit 18 të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”.

Shpallja e pontileve turistike të përkohshme bëhet me vendim të këshillit të qarkut, me propozimin e kryetarit të njësisë vendore, që ka në juridiksion territorin ku ndodhet pontili, sipas kriterëve të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 9

Kontrolli shtetëror

Në portet turistike për trafik ndërkombëtar e kombëtar dhe në pontile, institucionet përgjegjëse, sipas përgjegjësisë të fushës së veprimtarisë së tyre, ushtrojnë kontroll për sigurinë e mjeteve, kontroll doganor për bagazhet, kontroll për trafiqet e paligjshme e kontrabandën, si dhe ndaj veprimeve terroriste e për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotjet.

KREU II

PORTET TURISTIKE PËR TRAFIK NDËRKOMBËTAR

Neni 10

Kërkesat për portet turistike për trafik ndërkombëtar

Portet turistike për trafik ndërkombëtar duhet të kenë:

- a) autoritetet përgjegjëse shtetërore, për kryerjen e funksioneve të dhëna sipas ligjit (kapiteneria e portit, policia kufitare, dogana, shëndetësia, si dhe organe të tjera shtetërore);
- b) administratën e portit turistik, për ushtrimin e veprimtarisë brenda kërkesave të ligjit;
- c) të gjithë infrastrukturën e nevojshme bazë e atë operative, si dhe masat e tjera teknike, që lidhen me sigurinë e pronës e të jetës së njeriut në det dhe të mbrojtjes së mjedisit detar nga ndotjet.

Neni 11

Trafiku në portet ndërkombëtare

Portet turistike për trafik ndërkombëtar shërbejnë për të mundësuar trafikun e mjeteve turistike nga/për në Republikën e Shqipërisë, portet turistike kombëtare, si dhe pontilet e përhershme e të përkohshme.

KREU III

PORTET TURISTIKE PËR TRAFIK KOMBËTAR

Neni 12

Kërkesat për portet turistike për trafik kombëtar

Portet turistike për trafik kombëtar duhet të kenë:

- a) administratën e nevojshme, për ushtrimin e veprimtarisë dhe kryerjen e funksioneve të parashikuara në ligj;
- b) infrastrukturën e nevojshme bazë e atë operative, si dhe masat e tjera teknike, që lidhen me sigurinë e pronës e të jetës së njeriut në det dhe të mbrojtjes së mjedisit detar nga ndotjet.

Neni 13

Trafiku në portet kombëtare

Portet turistike për trafik kombëtar shërbejnë për të mundësuar trafikun e mjeteve turistike nga/për në të gjitha portet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, portet turistike kombëtare, si dhe pontilet e përhershme e të përkohshme.

KREU IV PONTILET TURISTIKE

Neni 14

Pontilet e përhershme dhe të përkohshme

Mjetet turistike veprojnë në pontilet e përhershme dhe të përkohshme për në/nga të gjitha portet turistike për trafik ndërkombëtar dhe kombëtar të Republikës së Shqipërisë.

Në pontilet e përhershme dhe të përkohshme lejohet të kryhet veprimtaria e përmendur në pikën 1 të nenit 5 të këtij ligji.

KREU V E DREJTA MBI HAPËSIRËN DETARE DHE BREGDETIN

Neni 15

Zbatimi i konventës së Kombeve të Bashkuara “Për të drejtën e detit” dhe të konventave të tjera detare

1. Në të gjitha portet turistike për trafik ndërkombëtar dhe kombëtar, në pontilet e përhershme dhe të përkohshme, institucioni përgjegjës zbaton kompetencat dhe standardet e kërkuara nga konventa ndërkombëtare “Për të drejtën e detit”, konventat ndërkombëtare detare dhe legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

2. Veprimtaria lundruese e mjeteve lundruese turistike rregullohet në bazë të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe të marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe, të ratifikuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

KREU VI DISPOZITA TË VEÇANTA

Neni 16

E drejta e ushtrimit të veprimtarisë

Veprimtaritë e lejuara në portet turistike, sipas nenit 5 të këtij ligji, kryhen pas marrjes së lejes së veprimtarisë nga organet përgjegjëse, në mbështetje të legjislacionit në fuqi.

Neni 17

Kundërvajtjet dhe sanksionet

Për veprat e kundërligjshme detare, të cilat kanë lidhje me sigurinë e mjeteve lundruese, zbatimin e legjislacionit për ndotjen e mjedisit detar, zbatimin e legjislacionit për regjimin e lundrimit në ujërat territoriale dhe ato të brendshme të Republikës së Shqipërisë, zbatohen procedurat dhe sanksionet e përcaktuara në pjesën e tetë, neni 369 deri në nenin 395 të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”.

Neni 18

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 5, 6, 7 e 8 paragrafi i dytë të këtij ligji.

Neni 19

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5271, datë 17.4.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

**REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË RTSH-SË PËR VITIN 2006**

Kuvendi, pasi u njoh me raportin e Këshillit Drejtues të RTSH-së për vitin 2006, vëren se:

- Këshilli Drejtues i RTSH-së raporton në Kuvend në kushtet kur si institucion drejtues i RTSH-së ka vetëm disa muaj që është zgjedhur në detyrë;
- RTSH-ja vepron në kushtet e konkurrencës së operatorëve të tjerë në tregun mediatik dhe për të balancuar përparësitë që zotëron, duhet dhe po punon për përmirësimin e parametrave teknologjikë dhe të kushteve të tjera që lidhen me to;
- Këshilli i ri Drejtues ka bërë përpjekje për përmirësimin e punës së RTSH-së, duke ndërmarrë masa sidomos në ndryshimet e stafit ekzekutiv të këtij institucioni;
- ka përpjekje nga ana e strukturave drejtuese të RTSH-së për vënien në lëvizje të procesit të reformimit të RTSH-së drejt një televizioni krejtësisht publik, siç e përcakton ligji;
- kërkohet një mbështetje më e madhe e strukturave shtetërore, në mënyrë që RTSH-ja të realizojë këtë qëllim, si dhe një rishikim i kuadrit ligjor e normativ, që rregullon veprimtarinë e këtij institucioni.

Kuvendi vlerëson se:

- ka arritje në drejtim të rritjes së pavarësisë editoriale në programet e RTSH-së;
- ka realizime në përmirësimin e strukturës programore të RTSH-së dhe drejtimin e saj kah publiku.

Për këtë Kuvendi kërkon nga Këshilli Drejtues dhe strukturat drejtuese të RTSH-së që:

- strukturat drejtuese të RTSH-së të njihen më mirë me detyrimet ligjore dhe detyrimet që rrjedhin nga rezolutat e miratuara deri tani nga Kuvendi për veprimtarinë e RTSH-së, ku përcaktohen drejtime të rëndësishme të punës në RTSH;
- të zbatojë detyrimin ligjor të përcaktuar në nenin 120 të ligjit nr.8410 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” dhe në statutin e RTSH-së për publikimin e raportit të analizës financiare të Bordit të Administrimit të RTSH-së;
- të hartojë brenda këtij viti kalendarik strategjinë e shndërrimit të plotë të RTSH-së në transmetues publik;
- të realizojë sa më parë detyrimin ligjor të përcaktuar në nenin 71 të ligjit nr. 8410 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” për mbulimin me sinjal të popullsisë dhe territorit në Republikën e Shqipërisë;
- të realizojë detyrimet ligjore dhe institucionale që kanë të bëjnë me miratimin e strukturës organizative, programore dhe reformën e pagave në RTSH;
- të përgatisë dhe të hartojë propozimet e veta në procesin e rishikimit të legjislacionit të ndërmarrë nga Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik dhe në mënyrë të veçantë të statutit të RTSH-së, duke marrë në konsideratë vërejtjet dhe sugjerimet e bëra nga ekspertët e institucioneve ndërkombëtare dhe detyrimet që ka Republika e Shqipërisë në kuadrin e procesit të stabilizim-asociimit
- të lirojë mjediset e duhura për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit.

5 prill 2007

**REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE
KONTROLLIT TË PASURIVE PËR VITIN 2006**

Kuvendi i Shqipërisë,

- duke njohur dhe mbështetur punën e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si një institucion i pavarur që ka kryer një punë voluminoze për kontrollin e deklarimit të

pasurisë, të detyrimeve financiare dhe parandalimin e konfliktit të interesave;

- duke vlerësuar punën e këtij institucioni, i cili e ka krijuar shumë shpejt fizionominë e tij në përputhje me ligjin;

- duke përkrahur kontributin e tij për forcimin e luftës kundër korrupsionit;

- duke nxitur veprimtarinë e tij për përmirësimin e kuadrit ligjor për zhvillimin e një procesi sa më transparent për kontrollin e deklarimit të pasurive,

Konstaton:

- Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive ka treguar profesionalizëm në procesin e kontrollit të pasurisë dhe detyrimeve financiare, si dhe në parandalimin e konfliktit të interesave, sipas përcaktimeve të bëra në ligj, për të zgjedhurit, për nëpunësit publikë, për familjarët e tyre dhe për personat e lidhur me ta;

- ka dëshmuar një vullnet të mirë për bashkëpunimin me institucionet publike, qendrore dhe vendore, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë trajnimit të punonjësve të këtyre institucioneve në luftën kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik;

- i ka kushtuar një kujdes të veçantë raporteve me median, pa krijuar diferencime në publikimin e informacioneve dhe duke u bazuar në ligjin “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

Kuvendi kërkon për vitin 2007:

- vazhdimin e angazhimit të institucionit në zbatimin e legjislacionit për kontrollin e pasurisë, të detyrimeve financiare, si edhe për parandalimin e konfliktit të interesave, sipas përcaktimeve të bëra në ligj;

- korrektesë maksimale në luftën kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik;

- vëmendje të veçantë dhe vetiniciativë në identifikimin e problemeve që lindin gjatë zbatimit të legjislacionit përkatës dhe propozimin e amendimeve për përmirësimin dhe rritjen e efektshmërisë së tij.

10 prill 2007

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR
3. REGJISTRAT E NOTERISË
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

1.	PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2.	PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3.	PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5	PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8	PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
9	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 23.4.2007
Doli nga shtypi më 24.4.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Grafon"
Tiranë, 2007

Çmimi 32 lekë